



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:165330

Datë: 25.03.2025

Numri i dokumentit: 07042274

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.233/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Naim Rekaliu, me zyrtaren ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.P nga Vushtrria, rr. "...", të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. Avdi Dinaj, për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.951/23 të datës 01.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 20.03.2025, në praninë e Prokurores së Shtetit Klodina Gashi, të pandehurit A.P dhe mbrojtësit të tij Av. Avdi Dinaj, në të njëjtën datë shpalli, ndërsa me datë 25.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.P, nga i ati R..., e ëma P..., e vajzërisë S..., i lindur më ..., në Vushtrri, rr. "...", me numër personal ..., të kryer shkollën e mesme, i punësuar si kamarier në restorantin "...", i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa gjykuar.

ËSHTË FAJTOR

I. SEPSE: Me datë 04.02.2023, rreth orës 01:30, në rrugën “...” në Vushtrri, i pandehuri për herë të parë pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit kanabis-marihuanë me peshë neto prej 0.76g, ashtu që pasi ishte ndaluar, gjatë verifikimit dhe kontrollit të veturës “Golf VI” ngjyrë e zezë, me targa ... dhe kontrollit të të pandehurit, i ishte gjendur substanca narkotike e mbështjellë në qese najloni.

Me këtë ka kryer veprën penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 38, 39, 40 dhe 43 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 269, 276, 364 dhe 450 të KPPK-së,

E G J Y K O N

I. ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 500€ (pesëqind euro), i cili dënim duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i pandehuri refuzon të paguaj dënimin me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të pandehurit për çdo njëzetë (20) euro të dënimit me gjobë, nga një (1) ditë burgim.

II. KONFISKOHET nga i pandehuri A.P, substanca narkotike e llojit kanabis marihuanë, me peshë neto 0.76 gram.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej tridhjetë euro (30€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.951/23 e datës 01.08.2023 kundër të pandehurit A.P nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.03.2025, në të cilën seancë ka prezantuar Prokurorja e Shtetit Koldina Gashi, i pandehuri A.P dhe avokati mbrojtës Avdi Dinaj.

Pas leximit të aktakuzës, nga ana e Prokurores së Shtetit, dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, si dhe sqarimit të benefiteve dhe pasojave të pranimit të fajësisë, të njëjtit i është ofruar mundësia që të deklarohet lidhur me fajësinë. I pandehuri A.P ka deklaruar se ndjehet fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, ka shtuar se pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij e pranon fajësinë, është penduar për atë që ka bërë, si dhe gjykatës i ka premtuar se nuk do të posedojë më narkotikë dhe se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin.

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i ka propozuar gjykatës që ta bëjë pranimin e fajësisë, pasi pranimi i fajësisë është bërë konform dispozitave ligjore të nenit 242 të KPRK-së, si dhe është në mbështetje të provave që e mbështesin aktakuzën, është bërë në mënyrë vullnetare dhe pas konsultimeve me mbrojtësin e tij. Po ashtu ka shtuar se me rastin e caktimit të dënimit gjykata të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Avokati mbrojtës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin e tij kanë vendosur që ta bëjnë pranimin e fajësisë, dhe gjykatës i ka propozuar që me rastin e vendosjes ta bëjë pranimin e fajësisë sipas aktakuzës, ndërsa me rastin e shqiptimit të ndonjë mase i ka propozuar gjykatës që të i shqiptojë një dënim me gjobë dhe atë për faktin se edhe ligji në par. 2 parasheh së pari dënimin me gjobë dhe atë duke pasur një mori rrethanash lehtësuese se më parë nuk ka qenë i gjykuar, ndaj tij nuk zbatohet ndonjë procedurë për ndonjë vepër tjetër penale, është i moshës së re, kështu që për veprimet e ndërmarra është penduar thellë dhe i vie keq për rastin që ka ndodhur.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 242 par. 2 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Faktet e çështjes në raport me provat që përmban aktakuza.

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit A.H në stacionin policor në Vushtrri, i datës 04.02.2023, raporti i policëve M.B dhe D.M i datës

04.02.2023, raporti i ekspertimit me numër AKF/2023-1278, i datës 12.06.2023, pesë fotografi nga vendi i ngjarjes, informacionet për të kaluarën e të pandehurit A.P, të marra nga data baza e Policisë së Kosovës, procesverbali mbi intervistimin e të pandehurit A.P në stacionin policor në Vushtrri, i datës 04.02.2023, si dhe shkresat e tjera të lëndës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësues dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 2 tw KPRK-sw, për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuari vendosi që të shqiptoj dënim me gjobë në lartësi prej 500 (pesëqind) euro i cili dënim do të paguhet nga i akuzuari në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj gjobën, do ti zëvendësohet me burgim, ku për çdo 20 euro gjobë do të llogaritet një ditë burgim.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të akuzuarin për rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara, e të përmendura nga ana e Prokurores së Shtetit, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari në shqyrtimin fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu ka shfaqur pendimin e tij, për veprën e kryer dhe se nga kryerja e kësaj vepre penale, i pandehuri më nuk ka ra ndesh me ligjin, ndërsa nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret gjeti shkallën e rrezikshmërisë që paraqet kjo vepër në raport me personat në përgjithësi, e veçanërisht me moshën e të pandehurit, dhe duke u nisur nga këto rrethana dhe në kuptim të nenit 38 dhe 43 të KPRK-së gjykata vendosi që ndaj të akuzuari të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata erdhi në përfundim se lartësia e dënimit me gjobë prej 500 (pesëqind euro) është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin

e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin lidhur me konfiskimin e substancës narkotike, gjykata e ka marr në bazë të nenit 269 par.1 e në lidhje me nenin 276 KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe nenit 450 par. 1 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.233/2023, datë 25.03.2025

Zyrtarja Ligjore

Arta Jusufi

Gj y q t a r i

Naim Rekalio

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.